



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË**  
**27.11.2025**

Me datë 27.11.2025, u mbajt mbledhja e Këshillit Bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Edmond Ndou, Jona Leqejza, Fatbardh Dama, Vjollca Petani, Erald Erkocaj, Armela Brahimi, Ardit Taflaj, Mirsad Bashi, Hedije Nasa, Alma Mehmetaj, Erlinda Kavaja, Taulant Shahmani, Jurgena Bracaj, Gjovalin Ndoj, Aleksander Pashuku, Florian Bjanku, Joniz Osmanagaj, Irena Shala, Irma Kopliku, Artan Haxhi, Gjenarin Kapcari, Elis Doci, Eliona Shkrela, Ardit Behri, Glorja Shllaku, Gjergj Sokoli, Rezarte Pode, Lulash Nika, Jetmira Rraboshta, Ervin Brahimi, Marina Duhani, Sead Jusha, Violeta Perndrecaj, Samed Bushati, Suada Kopshti, Plarent Anamali, Amina Lici, Muharrem Shkjau.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit **Z.Oltion Luli**

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. *Projektvendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Tetor 2025".*
2. *Projektvendim: "Për plotësimin e vakancës dhe dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak, Z.Sead Jusha".*
3. *Projektvendim: "Për deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të këshilltares bashkiake Znj.Bledianë Osja".*
4. *Projektvendim: "Për miratimin e planit të lëvizshmërisë së qëndrueshme urbane për Shkodrën".*
5. *Projektvendim: "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKB nr.1, datë 22.01.2025 "Për Taksat dhe Tarifat vendore në Bashkinë Shkodër", i ndryshuar*
6. *Projektvendim: "Për miratimin e planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore" "Rosek Drisht" dhe "Drin Gjadër Kir", Bashkia Shkodër*

7. *Projektvendim: "Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga Fondi Pyjor Kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi private të Z. Ded Kaci, zhvillues shoqëria "Star Plus" shpk brenda territorit të Bashkisë Shkodër".*
8. *Projektvendim: "Për miratimin e zbatimit të projektit Arti për Europën (ARTE), në kuadër të programit CERV - Netëork of Toën".*
9. *Projektvendim: "Për një ndryshim në VKB nr.69, datë 30.10.2017 "Pë miratimin e memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër si dhe metodologjinë LOD për financimin e organizatave të shoqërisë civile".*
10. *Projektvendim: "Për strehim emergjent të familjes L.Selja dhe T.Gomila në njësitë e banimit tek banesat sociale me qira pranë ish Konviktit të Veterinares".*
11. *Projektvendim: "Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri".*
12. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Kourumi i domosdoshëm është prezent në sallë, mbledhja deklarohet e hapur.

**Z. Luli** bën leximin e rendit të ditës, i cili hidhet në votim ku rezultojnë 32 vota Pro 0 Kundër 0 Abstenim. Miratohet

Fjalën e merr **Znj.Pode**, e cila propozon që pika 1,10 dhe 11 e rendit të ditës të kalohen pa relativim.

**Z.Luli** thotë se para se të kalohet tek pikat e rendit të ditës do kalohet në votimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit bashkiak datë: 31.10.2025.

Procesverbali hidhet në votim , ku rezultojnë 32 vota Pro 0 Kundër 0 Abstenim. Miratohet

Fjalën e merr **Znj.Duhani** e cila shpreh një kërkesë në lidhje me një qytetare që kërkon të marrë pjesë në mbledhje. Ajo shton se duke qenë se mbledhjet e Këshillit janë të hapura për qytetarët, ajo kërkon që asaj t'i lejohej të hyjë në sallë dhe të shpreh problematikën e saj. Mund ta hedhim edhe në votim shprehet ajo.

Sqaron **Z.Luli** duke thënë se duhet të paraqitet kërkesë me shkrim në sekretarinë e Këshillit më parë për të qenë prezent në mbledhje.

**Znj.Duhani** përsëri thotë se mbledhjet janë të hapura dhe nuk ka pse qytetarja të mos jetë e pranishme në sallë.

**Z.Luli** përsërit se mbledhjet e Këshillit janë të hapura dhe transparente për qytetarët por më parë duhet të ketë një kërkesë me shkrim për këtë.

Edhe **Z.Anamali** shprehet dakord me kërkesën e Znj.Duhani që qytetarja duhet të futur në sallë sepse nuk ka asnjë detyrim ligjor për të paraqitur kërkesë paraprakisht.

**Z.Luli** insiston që qytetarja duhet të paraqesë më parë një kërkesë me shkrim për të ditur arsyen, pasi në të kundërt kjo mund të kthehet në precedent.

Vijohet me pikën e parë të rendit të ditës, ku kryetarët e grupeve, **Z.Ndou** dhe **Z.Sokoli** shprehen pro projektaktit, kurse **Znj.Shala** shprehet gjithashtu pro por kërkon që qytetarja të marrë pjesë në mbledhje, pasi nuk është e nevojshme për kërkesën.

**Z.Luli** thotë se mbledhjet për transparencë transmetohen live dhe nuk ka pse të marrin pjesë qytetarët pasi nëse do të lejoheshin të gjithë atëherë salla do ishte e pamjaftueshme.

Vijohet me diskutime. Përsëri insiston **Z.Anamali**, **Z.Shkjau** dhe **Z.Osmanagaj** që zonja duhet të marrë pjesë në sallë.

**Z.Erkoçaj** merr fjalën dhe shprehet se Zonja ka një problem me çatinë e shtëpisë dhe kërkon zgjidhje, prandaj duhet të lejohet të hyjë në sallë.

**Z.Luli** përsëri thotë se qytetarët nuk mund të marrin pjesë dhe të diskutojnë problemet e tyre në mbledhjet e Këshillit Bashkiak.

Anëtarët e Këshillit kërkojnë që qytetarja duhet të lejohet të hyjë në sallë. Vijohet me replica dhe diskutime mbi këtë kërkesë.

**Z.Luli** shprehet se ai është i hapur për çdo gjë që është konform ligjit dhe rregullores por në rastin konkret nuk kemi një kërkesë me shkrim të depozituar, për më tepër qytetarja nuk ka të drejtë fjale.

Edhe **Z.Bjanku** dhe **Z.Osmanaga** insistojnë në lejimin e qytetarës në sallë dhe të ndjekin mbledhjen.

**Z.Shkjau** del në foltore dhe kërkon që qytetarja të hyjë në sallë.

Për këtë arsye **Z.Luli** kërkon 5 minuta pushim.

Pas pushimit prej 5 minutash dhe paraqitjes të paraqitjes së kërkesës me shkrim nga ana e qytetares, vijohet me pikën e parë të rendit të ditës: *Projektvendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Tetor 2025"*.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **33** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën 2.; *Projektvendim: "Për plotësimin e vakancës dhe dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak, Z.Sead Jusha"*.

**Z.Ndoj**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Mandateve lexon relacionin e mbajtur në mbledhjen e këtij komisioni.

**Z.Luli** vijon e leximin e formulës së betimit. Më pas **Z.Jusha** bën betim dhe projektakti hidhet në votim, ku rezultojnë **39** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika 3. e rendit të ditës: *Projektvendim: "Për deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të këshilltares bashkiake Znj.Bledianë Osja"*.

Përsëri **Z.Ndoj**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Mandateve lexon relacionin e mbajtur në mbledhjen e këtij komisioni.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **36** vota Pro **1** Kundër **2** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën 4. të rendit të ditës: *Projektvendim: “Për miratimin e planit të lëvizshmërisë së qëndrueshme urbane për Shkodrën”*.

Relaton për këtë pikë **Zv/kryetari Rudin Beka**, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

**Z.Bjanku** merr fjalën dhe shprehet se dëgjesat publike, që kemi herë pas here bëhen me qytetarë. Ne jemi përfaqësues të qytetarëve në Këshillin Bashkiak dhe patjetër, që ne mund të vijnë natyrisht por nuk e zëvendëson prezencën e specialistëve, pra përfaqësuesve të studios së kontraktuar për të diskutuar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak. Mbledhja e Këshillit Bashkiak ka një kontekst krejt tjetër, domethënë në kuptimin e një anëtarit të Këshillit Bashkiak. Ai kërkon të dijë se çfarë kosto ka ky plan në qoftë se do të implementohet në të gjitha fazat e tij? Dhe për sa vite parashikohet që të implementohet afati maksimal dhe i plotë i këtij planit?

Përgjigjet **Z.Beka** thotë se pjesa e planit të mobilitetit është pjesë e projektit të “Porta e Alpeve”, që është një projekt i nisur me iniciativën e Bashkisë për dëshirën për të sjellë investime në veri. Dhe Bashkia e Shkodrës është gati përfituese direkte. Dhe këto janë investime të integruara, të cilat përgjithësisht nxitin të zhvillohen turizmit, investimet publike, në transport, në infrastrukturë urbane etj.

Vijon **Z.Bjanku** duke thënë se a mendoni se ky plani i dekurajimit të lëvizshmërisë me mjete në qendër të qytetit shkon kundër iniciativave të fundit dhe lejeve që po jep Këshilli Kombëtar i Territorit për banesat shumëkatëshe në qendër të qytetit dhe në qendër të Velipojës. A mendoni se ka një lloj kontradite në këtë rast? A janë koordinuar këto elemente?

**Z.Beka** përsëri thotë se ky është një plan 10 vjeçar dhe dihet që këto lloj planesh janë të adaptueshme dhe dinamike përsa i përket lëvizjes. Pjesa ose zonat që mendojmë të dekurajojnë lëvizjen janë kryesisht zonat historike të qytetit.

**Z.Bashi** përgëzon iniciativën dhe mendoj se është shumë positive, por duhet të kemi vetëm kujdes në vijim me lëvizjen e autobusave dhe parkimet e qytetarëve.

**Znj.Golemi** kërkon të dijë se cilat janë zonat me kufizim oraresh, konkretisht zona e Zdrales, si është menduar aty lëvizja e makinave?

Përgjigjet për këtë **Z.Rasel Teli**, specialist në drejtorinë e Planifikimit të Territorit duke thënë se ky plan nuk i prek oraret në fakt, ka fleksibilitet por do shihen në vazhdimësi. Si kjo zonë kemi edhe zona të tjera. Kjo do detajohet në një moment të dytë, pra këto janë pjesë e politikave në vazhdim.

Përsëri **Znj.Golemi** shpreh shqetësim në lidhje me bulevardin Mehmet Pashë Plaku, në të cilin krijohet një trafik shumë i rënduar duke qënë se është hyrja e qytetit dhe ka shumë shkolla dhe kopshte në atë zonë. Si është menduar të ndërhyhet në uljen e trafikut aty?

**Z.Beka** thotë se ky është një problem i vazhdueshëm që kemi me shkollat dhe kopshtet. Është diskutuar disa herë që të rikthehet me 2 sense rruga "Xhabiej", që të liroj sado pak trafikun në rrugën në fjalë por do shihet në vazhdim.

**Znj.Golemi** shprehet përsëri se kohët e fundit janë shtuar shumë në rrugë parkimet e dedikuara me pagesë. A është menduar edhe këtu një zgjidhje për qytetarët që kanë nevojë të parkojnë.

Përsëri **Z.Teli** thotë se sugjerimi i planit është që të parkohet me fasha oraresh. Gjithmonë duke patur 20% parkime të lira për qytetarët.

Edhe **Z.Beka** shton se në vijim do mundohemi ti japim përparësi rezidentit duke e pajisur me kartë.

**Z.Doçi:** A ka një strategji për parkimet sepse qytetarët e Shkodrës po gjobiten pa fund?

Përgjigjet **Z.Beka** duke thënë se gjobat vendosen sipas ligjit dhe në asnjë moment nuk abuzohet me këtë pjesë. Si zgjidhej është menduar edhe që të fillohet me parkime të nëndheshme.

**Znj.Duhani** merr fjalën duke thënë se në vazhdimësi të idesë së kolegëve parafolës, unë po flas për zonën e Gjuadolit. Unë jam banore aty, dhe nuk kam mundur të hyj në garazhin e shtëpisë time. Më është dashur të pres deri si të mbarojë muzika, sepse bllokohen komplet rrugët e Gjuadolit. Si do t'i japin zgjidhje asaj zonë? Sepse ajo zonë është me familje, është ndër zonat më të vjetra në Shkodër dhe ato kanë dhe oborre. Ne të tjerët kemi edhe parkingje aty, kemi parkingjet tona. Si do t'ia bëjmë ne të hyjmë nëpër shtëpitë tona?

Përgjigjet **Z. Beka** duke thënë se ne kemi provuar edhe me pistonat, është mundësia. Por pistonat janë prishur që në javën e tretë sepse është problem edhe se kush do ta komandojë, është problem edhe për ta identifikuar se kush do futet. Dhe për hir të vërtetës, ishte e mundur vetëm për ta bllokuar me policinë, sepse kishim shumë kërkesa, edhe nga vetë banorët, edhe nga bizneset e tjerë që futen jashtë orarit. Gjobat fatkeqësisht janë shumë të ulëta sepse është zonë turistike. Kështu që mund të përdorim disa masa sepse është një zonë që nuk është lehtësisht e menaxhueshme, vetëm me pistonat.

Përsëri **Znj.Duhani** thotë se përveç kësaj, unë kam ankesë edhe për pjesën e lejeve që keni dhënë lokaleve ju, sepse në pikun e verës sidomos aty nuk mund të kalohet. Po të kesh një urgjencë, aty bllokohet komplet. Kontrollon dy-tre ditë nga Policia bashkiake dhe pas dy-tre ditëve i ke tavolinat përsëri. Edhe kjo është vërtet shqetësuese.

**Z.Doçi** thotë se gjobat nuk funksionojnë në këtë pjesë. Ai mendon se në raste të tilla t'ë merret automjeti me karroatrec sepse në të kundërt nuk ka zgjidhje tjetër.

**Z.Shkjau:** Përsa i përket këtij zhvillimi, mendoj që nuk po menaxhohet mire, sepse ka plot hapësira të zëna, që Bashkia ka mundësi t'i bëjë parkingje. Janë hapësira të zëna nga pallatet, me gardhe e me lloj lloj mënyre, prandaj a keni ndonjë projekt për zhvillim që mes pallateve të bëhen

parkingje, për rezidentët. Kështu që nuk është pak, prandaj ne kemi mundësi si Bashki që këto hapësira t'i kthejmë parkingje, pse jo edhe me pagesë. Por ama të bëhen që të mos gjobiten njerëzit se s'kanë ku lënë makinat. Përse i përket kësaj, unë jam dakord. Jam dakord për miratimin, sepse zhvillimi është i domosdoshëm.

**Z.Pashuku** merr fjalën dhe thotë se te prezantimi i planit ishin dy nyje që janë problem për trafikun. Pra aty tek Harku i Bërdicës, që po bëhet segmenti i ri. Si është planifikuar aty, sepse për tek rruga e Velipojës, aty afër janë dy institucione fetare, është njësi administrative, është edhe shkolla. Edhe në dëgjesat publike të banorëve të njësisë administrative Bërdicë është ngrit si problematikë, sepse për arsye se aty është kundërvajtje, policia rrugore aty vendos gjoba gjithë kohës. Nuk e di si është menduar zgjidhja për këtë?

**Z.Teli**, përgjigjet se përse i përket planit, zgjidhja afatgjatë për problemin e segmentit në fjalë është krijimi i hyrjes së re të qytetit, hyrjes lindore, pra e bypass-it lindor. Kjo do të ndikojë direkt edhe në zgjidhjen ose në përmirësimin e atij problemi. Detajet pastaj janë pjesë e projektit që është duke u zbatuar nga ARRsh-ja, domethënë që zgjidhja i takon atij projekti, jo këtij plani.

**Znj.Shestani:** Atëherë, ne na kërkohet sot të miratojmë planin e mobilitetit të rrugëve. Në dijeninë time, ne nuk kemi akoma një vlerësim aktual të rrugëve sipas standardeve. Do doja të dija: Ky plan, a e ka marrë parasysh gjendjen aktuale të rrugëve? Domethënë, a kemi ne një vlerësim të gjendjes aktuale sipas standardeve të rrugëve? Kjo është e para, dhe e dyta është për parkingjet në Velipojë. Domethënë, unë jam krejt dakord që parkingjet nuk duhet të jenë në zonën me rërë. Por ama, parkingjet nëpër ato rrugë ku u tha, që do të jenë shumë më të shtrenjta dhe lëvizja do të bëhet drejt plazhit me Shuttlebus. A mendoni se kjo i bien nesh politikës që kemi për turizmin dhe për zhvillimin e turizmit në ato zona?

**Z. Beka.** Në lidhje pyetjen e dytë, atëherë Shuttlebus-i është një propozim për një periudhë pak më të gjatë jo periudhë afatshkurtër, por gjithsesi nuk mendojnë se e bie asaj politike, madje sipas mendimit tim i qëndron edhe projektit përse i përket turizmit, ekologjisë me më pak trafik, pra nuk është se i bie ndesh, është e kundërta, pra është pro saj. Në qoftë se lëviz me një makinë dhe merr njëzet persona brenda, apo të lëvizin njëzet makina, pra kjo është logjika. Prandaj është opsioni i shuttlebus-it dhe jo parkingjeve në rërë. Kurse përse i përket pyetjes të parë, ne kemi bërë vlerësime të rëndësishme si Bashki për situatën aktuale dhe për ndërhyrjen që ne po bëjmë në mënyrë të vazhdueshme, dhe kjo do jetë pjesë e integruar e planit të mobilitetit.

**Z.Galiqi:** E aprovoj shumë realizimin e planit të mobilitetit, sidomos metodologjia e realizimit si plan, ku punojnë ekspertë të huaj me urbanistat lokalë, ka shumë rëndësi për të përkuar në favor të realizimit të projekteve që janë konkretë dhe në favor të së mirës për qytetarët. Por mendoj që miratimi i këtij plani të mobilitetit praktikisht do të rrisë pak presionin edhe para struktura lokale, edhe para struktura qendrore për realizimin e disa projekteve imediate për qytetin. Për shembull, një nga projektet imediate për qytetin duhet të jetë, një qendër po e quajmë stacionesh për autobuza, që duhet të jetë një nga projektet e realizimit të shpejtë afatgjatë, në mënyrë që autobuzat të mos hyjnë në qytet, siç hyjnë aktualisht dhe parkojnë turistat brenda qytetit, sepse siç tha edhe Z.Beka me drejtë, në qytet duhet t'i jepet prioritet lëvizjes në këmbë dhe pedalimit, jo makinave. Kështu që besoj që kjo duhet të shërbejë për tu reflektuar në buxhetin e vitit 2026. Për të mos u

zgatur me diskutimin, mendoj që është një arritje e madhe për qytetin, aq më tepër që punojnë ekspertë të huaj. Dhe sigurisht ka për tu marrë në konsideratë, sepse ky plan do jetë si një diplomë e lëvizjes që duhet të merret në konsideratë kur jepen lejet për në qytet. Krasas kësaj do doja të dija: A është marrë në konsideratë Liqeni i Shkodrës si pjesë e mobilitetit? Aq më tepër që është një liqen kufi dhe mund të ketë lëvizshmëri midis dy shteteve.

**Përsëri Z. Beka:** Përsa i përket stacionit të autobusave janë dy propozime, dhe jemi në bashkëpunim edhe me drejtorinë e transportit, ku është gjetur një zonë që shihet si e përshtatshme, pranë stacioni i trenit, Për tu zgjeruar dhe për ti dhënë përparësi për sa i përket parkimit ose stacionit të autobusave. Ndërsa përsa i përket pyetjes së dytë të Liqenit, po, pjesa e Liqenit është e përfshirë në plan por për hir të informacionit shumë të madh që ka prezantimi nuk u ndalme. Madje një pjesë të saj edhe sot është ka filluar implementimi, pra përsa i përket zgjatjes së rrugës biçikletave. Jithashtu po bëhet një ndërhyrje në fshatin Zogaj, ku është pjesë e mobilitetit, në të cilat do shtrohet edhe me kalldrëm, më shumë për kalim me këmbë dhe biçikletë, jo me makina. Po ashtu sugjeruar që edhe për Liqenin e Shkodrës të kalojmë me përdorim lejesh, për barka elektrike. Të gjitha këto do jenë pjesë e mobilitetit apo të ekonomisë blu, që ne kemi si prioritet kryesor në pjesën e menaxhimit ekonomik.

**Z. Anamali:** Atëherë, një pyetje e thjeshtë në lidhje me planin. A mendoni ju që ky plan të jetë pjesë integrale e planit të përgjithshëm vendor? Pra, ideja që të jetë në sintoni me zhvillimin e qytetit?

**Z. Teli:** Ky plan strategjik i bashkëngjitet planit të përgjithshëm vendor të qytetit. Këta ecin krah për krah në shumë detaje. Pra do jenë në sintoni me njëri-tjetrin.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, Z.Ndou dhe Znj.Pode shprehen pro projektvendimit, kurse Znj.Shala shprehet se do abstenojnë duke qënë se ato mendojnë që plani ka nevojë për përmirësime.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **27** vota Pro **0** Kundër **10** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika 5. *Projektvendim: "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKB nr.1, datë 22.01.2025 "Për Taksat dhe Tarifat vendore në Bashkinë Shkodër ", i ndryshuar*

Relaton edhe për këtë pikë **Znj.Dama**, drejtoreshë e përgjithshme juridike, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

**Znj.Shkrela:** Atëherë unë kisha një pyetje tjetër fillimisht për të qenë më e sqaruar për çerdhet dhe kopshtet. Pagesa bëhet fjalë për familjarët që kanë fëmijët në kopsht dhe në çerdhe, duke ditur se çfarë kushtesh ekonomike ka në Shkodër. A është menduar kjo rritje se sa do rëndojnë për familjarët? Mendoj që Bashkia Shkodër, sikurse ka vepruar me tregtarët e Rusit le ta plotësojnë vetë këtë shtesë në mënyrë që të mos rrënojnë qytetarët shkodranë për fëmijët e tyre, si për kopshtet edhe për çerdhet.

Përgjigjet **Znj.Dama**: Për sqarim, arsyeja pse rriten, vjen për shkak të rritjes së çmimeve dhe duke mos dashur asnjëherë të bëjmë kompromise me standartet e ushqimit për fëmijët. Si pasojë edhe e implementimit të menusë së re, sot fëmijët ushqehen sipas standardeve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit për kopshtet dhe çerdhet me drekë. Prandaj është parë e nevojshme, që të rishikohet mënyra e tarifimit, pikërisht për t'i ardhë në ndihmë familjeve shkodrane dhe për të mos impaktu drejtpërdrejt në xhepat e qytetarëve. Tarifimi sipas kontratës që do të bëhet nga drejtoria përgjegjëse dhe do jetë për aq lekë sa shpenzohet realisht për ato fëmijë dhe jo me maksimumin.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, Z.Ndou dhe Z.Sokoli shprehen pro projektvendimit, kurse Znj.Shala shprehet kundër rritjes së tarifave.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **23** vota Pro **9** Kundër **1** Abstenim. **Nuk Miratohet**

Vijohet me pikën e radhës: *Projektvendim: “Për miratimin e planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore” “Rosek Drisht ” dhe “Drin Gjadër Kir”, Bashkia Shkodër*

Relaton për këtë pikë **Znj.Shllaku**, drejtoreshë Mjedisi në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata

**Znj.Golemi**: Kisha një pyetje, me sa di, ka qenë një plan dhjetëvjeçar i kaluar për këtë ekonomi. Meqenëse ky plan i ri parashikon të ardhura të konsiderueshme gjatë këtyre dy viteve të fundit, a ka patur më parë të ardhura të mbledhura nga kjo ekonomi?

**Znj.Shllaku**: Më fal, nuk ka pasur asnjë plan për këtë ekonomi pyjore. Ajo që unë thashë nuk ishte për ekonominë pyjore, thashë ka pasur disa plane të bëra nga ish-komunat. Ish-komunat kanë pasur sipërfaqe pyjore, të cilat nuk kanë qenë me ekonomi pyjore, por kanë qenë sipërfaqe pyjore në pronësi të komunave në momentin që pyjet i kanë kaluar bashkive. Për momentin nuk kemi patur të ardhura nga kjo ekonomi, por pretendojmë të kemi për lëndën drusore, në momentin që do kemi edhe përmbushje të një vakumi ligjor.

**Znj.Kopshti** : Po, duke qenë se në plan parashikohet të rritja e fondit pyjor, rivlerësimi i zonave të dëmtuara dhe zbatimi i praktikave të qëndrueshmërisë të kullotjes. Cilat janë mekanizmat kryesore që do përdorë Bashkia Shkodër për të siguruar plane të qarta, të cilat mund të zbatohen gjatë dhjetëvjeçarit të kontratës?

**Znj.Shllaku**: Nuk e kuptova mirë, megjithatë po sqaroj se cili është qëllimi i planit dhe politikat e Bashkisë. Plani i përcakton qartë se kush janë masat që duhen marrë. Masat kryesore, ashtu siç edhe u shpreha, kanë të bëjnë me përmirësimin e sipërfaqeve pyjore që kanë të bëjnë me investime, për mbrojtjen, për ndërtimin e pritave malore, për kullotat e bagëtive, për ndërtimin e lerave të ujit, për pastrimin e kullotave nga gurët dhe bërja e tyre të përdorshme apo edhe me punime stilvikulturore, siç mund të jenë prerja e degëve të pemëve apo dhe pastrimi, në mënyrë që të ketë mbrojtjen nga zjarri dhe përmirësimi i tyre.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, kryetarët e grupeve shprehen të gjithë pro projektvendimit.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **34** vota Pro **0** Kundër **1** Abstenim. **Miratohet**



Vijohet me pikën 7.: *Projektvendim: “Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga Fondi Pyjor Kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi private të Z. Ded Kaci, zhvillues shoqëria “Star Plus” shpk brenda territorit të Bashkisë Shkodër”.*

Relaton edhe për këtë pikë **Znj.Shllaku**, drejtoreshë Mjedisi në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, kryetarët e grupeve shprehen të gjithë pro projektvendimit.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **33** vota Pro **0** Kundër **2** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën 8. të rendit të ditës: *Projektvendim: “Për miratimin e zbatimit të projektit Arti për Europën (ARTE), në kuadër të programit CERV - Netëork of Toën”.*

Relaton edhe për këtë pikë **Znj.Mardusha**, drejtoreshë e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, kryetarët e grupeve shprehen të gjithë pro projektvendimit.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **30** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika tjetër e rendit të ditës: *Projektvendim: “Për një ndryshim në VKB nr.69, datë 30.10.2017 “Pë miratimin e memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër si dhe metodologjinë LOD për financimin e organizatave të shoqërisë civile”.*

Edhe për këtë projektvendim relaton **Znj.Mardusha**, drejtoreshë e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, kryetarët e grupeve shprehen të gjithë pro projektvendimit.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **31** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën 10. *Projektvendim: “Për strehim emergjent të familjes L.Selja dhe T.Gomila në njësitë e banimit tek banesat sociale me qira pranë ish Konviktit të Veterinares”.*

Siç është rënë dakord ky projektakt nuk ka nevojë për relativim, kryetarët e grupeve shprehen të gjithë pro projektvendimit.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **31** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika tjetër e rendit të ditës: *Projektvendim: "Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri"*.

Edhe kjo pikë nuk ka nevojë për relativim, të gjithë kryetarët e grupeve shprehin dakordësi me projektaktin.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë 32 vota Pro 0 Kundër 0 Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën e fundit të rendit të ditës: *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

**Z.Anamali:** Siç u diskutua në hyrje të kësaj mbledhje për një shqetësim në lidhje me një banesë shumëkatëshe që ndodhet tek zigzaku, pra në mes të Zdrales. Banesë, e cila ka tre muaj që është zbuluar çatia dhe po degradon dita-ditës dhe nuk po merret asnjë masë. Problematika, me sa kam informacion, ka filluar që në momentin që është dhënë një leje nga Bashkia Shkodër, gjoja për meremetim apo ndryshim të çatisë, të kësaj ndërtese. Që në vlerësimin tim që në atë moment ka qenë e gabuar, sepse një ndërtese e cila banohet nga shumë familje, çatia konsiderohet ambient i përbashkët dhe nuk mund të jepet leje vetëm për një subjekt i cili bën aplikim për atë pjesë, sepse duhet të merret miratimi i të gjithë familjeve që banojnë atë ndërtesë. Për më tepër është dhënë leje ndërtimi dhe është shfrytëzuar për të bërë një rritje artificiale shtesë kati. Dhe nga Bashkia e Shkodrës nuk është monitoruar faza e punimeve, gjë që ka sjellë pastaj edhe konflikt ndërmjet banorëve aty. Shqetësimi është shumë i madh, sepse ka tre muaj që, siç e thashë, janë në qiell të hapur dhe moti i keq ka influencuar duke degraduar pjesën më të madhe të kësaj ndërtese. Kërkohej që nga Bashkia të merren masa imediate në mënyrë që mos të degradojë më tepër kjo pjesë.

**Znj.Shkreli:** Atëherë, diskutimin e parë në fakt do ta kisha në formë kritike edhe për ju, si Kryetar i Këshillit Bashkiak, sepse kritikën tashmë për Kryetarin e Bashkisë vetëm sa rriten, por në momentin që Kryetari i Bashkisë bëhet edhe Këshill bashkiak duke vendosur edhe mbi Këshillin Bashkiak, kjo pastaj është e paprecedent. Është lëvizur një monument ai i 13 Dhjetorit, pa u miratuar në Këshillin Bashkiak. Ligji e thotë saktë që për vendosjen, lëvizjen apo heqjen e monumenteve apo busteve, duhet miratimi i Këshillit Bashkiak. Një situatë e tillë nuk duhet të ndodh më. Dhe kjo në radhë të parë vjen tek ju si kryetari i Këshillit Bashkiak, por patjetër ky është një akt që nuk duhet të pranohet as nga anëtarët e Këshillit Bashkiak, sepse në fund të fundit na jemi të zgjedhur me vota nga qytetarët shkodranë dhe Këshilli bashkiak, që ju e dini shumë mirë, është organ vendimarrës dhe Kryetari i bashkisë të kryejnë detyrat e veta dhe të mos hyjnë në kompetencat e Këshillit Bashkiak. Është e disata herë në fakt, që Kryetari i Bashkisë ndërhyr në kompetencat tona. Prandaj, ky të jetë rasti i fundit, se përveçse e ka hequr monumentin në fjalë, ka bërë edhe tjetrën që përsëri pa miratimin e Këshillit bashkiak e ka vendosur në një vend tjetër. E dyta, janë hapur disa gropa në rrugën Don Bosko, që ju i quani investime, ku të gjithë e dimë shumë mirë që aty janë disa shkolla edhe një qendër për fëmijë, një qendër gjithashtu rinore, ajo e oratorit Don Bosko dhe aty është një kaos me ato punime nuk po përfundojnë kurrë, sepse aty punohet një ditë dhe tre ditë jo. Tani që kanë filluar edhe shirat, rruga është bërë e pakalueshme dhe e rrezikshme për fëmijët. Aty punohet si duket vetëm kur ka nevojë Bashkia me ba propagandën në rrjetet sociale. Po ashtu janë hapur rrethrotullime, si rreth rrotullimi në Dobraq, rrethrotullimit tek policia. Nuk shihet askush aty duke punuar dhe ju hapni dhe i bëni të gjitha këto avash avash, që t'i përdorni kur të vijë koha e zgjedhjeve për të treguar se shihni se sa investohet e punohet. Prandaj kur ti filloni ato investime, mbyllini sepse përveçse ka biznese, thashë është edhe oratori Don Bosko, gjithashtu janë edhe shkollat e mesme dhe shkolla private.

Rruga Don Bosko është kthyer në gangrene. Prandaj merreni pak më me seriozitet, ju që thoni po bëjmë plane, se këtu pastaj nuk na jepni asnjë shpjegim. Dini vetëm të vendosni gjoka edhe ti merrni lekë qytetarëve me anë të policinë bashkiake, se tani e keni kthyer në organ gjobënie në fakt, më shumë sesa organ për rregullimin e situatës apo kaosit në rrugë.

**Znj.Duhani:** Atëherë, ndjej detyrim qytetar, ti rikthehem rastit që folëm në fillim të mbledhjes, sepse unë jam një këshilltare e zgjedhur nga qytetarët. Unë personalisht nuk e njihja zonjën, por e njihja vetëm nëpërmjet rastit, nëpërmjet lajmeve. Dhe rasti konkret është preokupues se bëhet fjalë për familjet që janë në qiell të hapur, pa çati. Kanë edhe dokumentat përkatëse, të cilat mund t'ju facilitoi pas mbledhjes, por për të mos u zgjatur, nuk më duket normale, që disa banorë të Shkodrës jetojnë në qiell të hapur, për më tepër nuk iu lejua të hynte fare në mbledhjen e këshillit, edhe pse vazhdon të jetë një shkelje të drejtës së saj qytetare.

**Z.Luli:** Atëherë, qytetarja është prezent në sallë për të dëgjuar mbledhjen e këshillit. Përsa i përket kërkesave, nuk ka hapësinë ligjore për ta bërë një gjë të tillë. Janë institucione të tjera, që merrën në të tilla raste, prandaj të mos krijojmë keqinterpretime.

**Z.Erkoçaj:** Nuk duhet lejohet që për një banesë, që ka tre muaj pa çati dhe banorët aty rrezikojnë jetën të mos gjendet një zgjidhje. Unë bëj thirrje dhe besoj se në emrin të gjithë këshilltarëve këtu, duhet që të merret përsipër mbyllja e çatisë. Bashkia duhet me patjetër që ta zgjidh këtë problem, sepse kanë tre muaj që jetojnë duke rrezikuar jetën në qiell të hapur. Kështu që ju lutem, merrni masa dhe flisni me banorët dhe gjeni një zgjidhje, sepse nuk është normale.

**Z.Shkjau:** Kisha një mendim, që besoj se na lejohet si Këshill që organet përkatëse të na japin sqarim përsa i përket rastit të kësaj qytetareje.

**Z.Luli** pyet se nga cila drejtori e kërkon përgjigjen?

**Z.Shkjau:** Nga IMT-ja.

**Zv/Kryetari Beka** përgjigjet se për rastin në fjalë, ai është një rast që ka kohë që është problem në Bashkinë Shkodër. Është takuar disa herë edhe me Kryetarin e bashkisë, me drejtuesat. Nuk është linja ime, domethënë nuk jam shumë mirë në dijeni të detajeve, por e di që është takuar vazhdimisht, qoftë me Kryetarin e bashkisë edhe me drejtuesat. Bëhet fjalë për një një konflikt të brëndshëm, i vetë banorëve të aty. Me sa jam në dijeni me ndërhyrjen e kryetarit, po gjendet një fond nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për të bërë edhe njëherë çatinë. Është dhënë leja dhe besoj se fillon shumë shpejt..

**Z.Doçi:** Zonja po kërkon diçka njerëzore.

**Z.Luli:** Nuk mundet të kërkojë një gjë të tillë në mbledhje Këshilli, I lejohet vetëm prezenca.

**Z.Doçi:** A ka mundësi, zoti Beka, sa kohë limit mund të kenë?

**Zv/Kryetari Beka:** Këtë nuk mund ta them , sepse nuk kam një datë të saktë, më duhet të marr informacion nga administrata që po merret me trajtimin e rastit.

**Z.Shkjau:** Faleminderit për sqarimin. Ne tani nuk jemi avokatë qytetarësh, këtu jemi këshilltarë. Qytetarja është e pranishme, tani mund të vazhdojë të ndjek instancat që duhen. Nuk duhet bëhet politike.

**Z.Behri:** Para rreth dy muajsh është bërë një ndërhyrje në bulevardin Mehmet Pashë Plaku. Aty Bashkia ka bërë shtrimin e gjithë bulevardit, por pastaj është bërë një ndërhyrje e OSHEE-së, me sa duket nuk ka kontaktuar me Bashkinë parë, se besoj se ndërhyrja mund të ishte bërë përpara. Është prish asfalti dhe akoma nuk është rregulluar. Ndërkohë që është rruga që ka trafikun më të madh, është hyrja e Shkodrës dhe ajo çdo ditë po degradon. Çdo ditë që kalon ai bulevard, po degradon. Do të doja një përgjigje, kur mund të ndërhyhet? A duhet të ndërhyjë Bashkia apo OSHEE-ja? Edhe diçka tjetër, mbledhjen tjetër, kolegu Pashuku bëri një kërkesë për banorët e njësisë administrative Bërdicë, në lidhje me mbylljen e një burimi uji, që ka furnizuar me ujë gjithë zonën e nën Shkodrës. Tani uji në fshatrat Bërdicë, Bërdicë e mesme, Bërdicë e madhe, Bërdicë e sipërme, shkon me orare. Fshati Trush nuk ka ujësjellës fare dhe e gjithë zona e nën Shkodrës është pothuajse pa ujë të pijshëm. A është e mundur të ndërhyhet për të komunikuar me UKSH-në për të gjetur një zgjidhje?

**Z.Beka** përgjigjet duke thënë se do interesohet direkt me ujësjellësin edhe me OSHEE-në për rastin fjalë dhe të kthejmë përgjigjen e saj javën që vjen me shkrim.

**Z.Pashuku** edhe njëherë në lidhje me këtë, realisht, që ai burim uji është bërë në formë private, sipas informacionit që kam. Dhe në dijeninë time Drejtoria e policisë rrugore ka ndërhyrë për arsye se gjoja aty është burim aksidentesh. 20 metra më larg atij burimi është një vend publik, pronë e Bashkisë Shkodër, ku ndërmarrja e ujësjellësit në bashkëpunim me ndërmarrjen e shërbimeve publike duke kontaktuar edhe administratorin e njësisë Bërdicë, mund ta përcaktojnë vendin, ku mund të bëhet një investim modest thjeshtë për banorët e njësisë administrative të Bërdicës. Është është e zgjidhshme besoj.

**Znj.Shllaku:** Duke u nisur nga ata që tha më parë kolegja ime Eliona në lidhje me monumentet. Duhet të theksoj që Kryetari i bashkisë është organ ekzekutiv, ndërsa Këshilli bashkiak është organ vendimarrës, që do të thotë, përse i përket heqjes apo vendosjes së çdo monumendi nuk e ka të drejtën Kryetari i Bashkisë ta marrë iniciativën, por e ka Këshilli bashkiak. Prandaj, nuk duhet të lënë si në asgjë, sepse përbën shkelje ligjore për mos të hyrë më pas në hapa të mëtejshëm. Duke vazhduar në këtë linjë, do të doja të dija meqënëse është prezent nënkryetari i bashkisë, për vendosjen e skenës, a është marr parasysh ose a është menduar që ajo skenë ka mbuluar krejt monumentin e atë Gjergj Fishtës. Mendoj, që duhen respektuar këta figura kombëtare, është totalisht mungesë respekti vendosja e një skene aty. Për më tepër do doja të dija, sa i kushton kjo skenë qytetarëve të Shkodrës? Mendoj që duhet të ketë pak transparencë, gjë që nuk e vërejmë me asnjë investim. Duke kaluar edhe tek pika tjetër, për çdo investim që po bëhet në Shkodër nuk shohim tabala informuese që janë të detyrueshme për çdo banor të Shkodrës, për marr dijeni se kush është investitori, se sa lekë janë duke u përdorur etj etj.

**Znj.Shestani:** Atëherë, në mbledhjen e kaluar të Këshillit, unë kam kërkuar një informacion për të ardhurat në plazhin e Velipojës, për plazhet publike edhe më është thënë që gjatë kësaj mbledhje do të marrim një relacion në lidhje sa janë të ardhurat, ku do të përdoren, sa janë në buxhet, si do të veprimet me ta.

**Z.Luli** sqaron se në sallë nuk është asnjë prezent nga drejtoria, kështu që beson që informacioni do të përcillet nga Nënkryetari tek drejtoria, për t'ju përcjellë më pas tek ju.

**Z.Doçi:** Doja të flisja pak për rrugën e Bahçallekut, për pjesën ku po ndërtohet. Ajo rrugë nuk ka as s'ka sinjalisti ku po punohet, asgjë. Është burim aksidenti domethënë, përgjegjshmëria aty është në maksimum. Pra, s'ka sinjalistikë, kështu ka asgjë, natën nuk orientohesh dot. Dy kilometra duhet të ishin mbaruar me kohë, a mund të dimë sa kohë ju duhet që ta mbaroni atë pjesë në atë segment?

Përgjigjet **Z.Beka:** Do ta përcjellim, është e vërtetë, do të përcjellim te firma këtë shqetësim që ju keni. Do diskutojmë direkt me firmën që ka marrë përgjegjësinë e rrugës.

**Z.Shkjau:** Sipas informacioneve që kam, një rrethrotullim te kjo rrugë mendohet të bëhet diku tjetër. Mendoj që Bashkia duhet të shpreh mendimet e veta, të paktën të bëhet aty ku ka qenë. Mos të mos dëmtohen më tepër qytetarët që janë aty përqark. Sepse ka ankesa prej qytetarëve të Bahçallëkut, prandaj duhet të shihet mirë vendi i rrethrotullimit.

*Pyetje e diskutime të tjera nuk ka, Z.Luli e deklaron mbledhjen të mbyllur.*

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër të datës 27.11.2025. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 14 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

**V.o: Ky procesverbal do miratohet nga anëtarët e Këshillit në mbledhjen e radhës së Këshillit bashkiak.**

**Sekretar**

**Sabina DANAJ**

Zbardhi Pr/verbalin:

Irma Sulishti

**KRYETAR**

**Oltion LULI**